

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

## Kontabiliteti Financiar

# P1

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

## Problemi 1

Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve tregtare për Narta shpk. për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 është përgatitur nga një nëpunës llogarish dhe është si më poshtë:

### Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve tregtare

Saldo në fillim	145,300	Saldo në fillim	200
Shitjet me kredi	645,200	Çeqet e pranuar	586,800
Shitjet me para të gatshme	10,300	Paraja e gatshme e arkëtuar	15,900
Kontra hyrjet me LL/P	1,400	Kthimet e shitjeve	10,500
	_____	Saldo në fund (shifër balancuese)	<u>188,800</u>
	<u>802,200</u>		<u>802,200</u>

Nëpunësi i llogarive ishte i pakujdesshëm në përgatitjen e tyre dhe përveç gabimeve në llogarinë kontrolluese më sipër, u identifikuan gabimet e mëposhtme:

1. Një shitje me kredi prej €3,800 ishte harruar plotësisht nga llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve tregtare.
2. Në llogaritë individuale të klientëve, një borxh i keq i shlyer i cili është kthyer në shumë prej €1,600, nuk është paraqitur në llogarinë kontrolluese të arkëtueshmeve. Shuma është arkëtuar më 2 janar 2020.
3. Kthimet e shitjeve ishin të nënvlerësuara për €600.
4. Çeku i pranuar nga klienti në shumë prej €590 është paraqitur në llogarinë kontrolluese të të arkëtueshmeve si €950.
5. Nuk është shlyer një borxh i keq në shumë prej €600.
6. Kontra hyrjet me LL/P përfshijnë marrëveshjet për shlyerjen e borxheve, por nuk janë regjistruar saktë.
7. Çeqet e pranuar dhe paraja e gatshme e arkëtuar ishin për shitjet me kredi, përpos një shume prej €500 e cila ishte arkëtuar për shitjet me para të gatshme.

### **Kërkohet:**

- (a) Duke përdorur informatat si më lartë, paraqitni saktë Llogarinë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019.

**(15 pikë)**

- (b) Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht përfitimet e përdorimit të llogarive kontrolluese.

**(5 pikë)**

**[Totali: 20 pikë]**

## Zgjidhja e problemit 1

### Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve

Saldo në fillim	145,300	Saldo në fillim	200
Shitjet me kredi	645,200	Kontra hyrjet me LL/P	1,400
Shitja me kredi-shtesë (shënimi 1)	3,800	Çeqet e pranuar	586,800
Borxhi i keq i kthyer (shënimi 2) <sup>1</sup>	1,600	Paraja e gatshme e arkëtuar	15,900
Korrigjimi i çekut (shënimi 4) diferenca	360	Kthimet e shitjeve (10,500+600)	11,100
Korrigjimi i çekut për shitje me para të gatshme (shënimi 7)	500	Borxhi i keq	600
		<b>Saldo balancuese</b>	<b>180,760</b>
<b>Saldo përfundimtare</b>	<b>180,760</b>		

b)-Llogaritë kontrolluese mund të identifikojnë gabimet në listat individuale të klientëve

-Nëse Bilanci Vërtetues nuk barazohet, duhe të rishikohen vetëm kontot llogaritë kontrolluese të të cilave nuk barazohen.

-Llogaritë kontrolluese mund të rishikohen nga një person tjetër si kontrollori financiar për t'u siguruar nga mashtrimet

-Llogaritë kontrolluese e përshpejtojnë procesin e gjenerimit të informatave për menaxhmentin, pasi që saldot nga llogaritë kontrolluese mund të përdoren pa patur nevojë që të bëhet konsolidimi dhe nxerrja e saldove nga listat individuale.

-Llogaritë kontrolluese i zvogëlojnë detajet që nevojiten në librin kryesor.

<sup>1</sup> Për shkak se arkëtimi i parasë është bërë më 2 janar, nuk zvogëlohet LL/A

## **Problemi 2**

Jona sh.p.k. është e përfshirë në prodhimin e produkteve të ndërtimit dhe pasqyrat e saj financiare janë si më poshtë:

### **Jona shpk**

#### **Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor**

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë jo qarkulluese</b>		
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet	<u>13,350</u>	<u>11,320</u>
<b>Totali i pasurive jo qarkulluese</b>	<b><u>13,350</u></b>	<b><u>11,320</u></b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>		
Stoqet	2,240	2,100
Llogaritë e arkëtueshme	890	980
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	<u>78</u>	<u>80</u>
<b>Totali i pasurive qarkulluese</b>	<b><u>3,208</u></b>	<b><u>3,160</u></b>
<b>Totali i pasurive</b>	<b><u>16,558</u></b>	<b><u>14,480</u></b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali aksionar	300	250
Premia në aksione	120	100
Fitimet e mbajtura	10,460	9,240
Rezerva e rivlerësimit	300	200
<b>Totali i ekuitetit</b>	<b><u>11,180</u></b>	<b><u>9,790</u></b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Kredia afatgjatë	<u>3,500</u>	<u>3,000</u>
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b><u>3,500</u></b>	<b><u>3,000</u></b>
<b>Detyrimet afatshkurta</b>		
Llogaritë e pagueshme	1,640	1,560
Mbitërheqja bankare	90	50
Interesi i pagueshëm	18	-
Tatimi i pagueshëm	<u>130</u>	<u>80</u>
<b>Total Detyrimet afatshkurta</b>	<b><u>1,878</u></b>	<b><u>1,690</u></b>
<b>Total Ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b><u>16,558</u></b>	<b><u>14,480</u></b>

#### **Shënime:**

2. Fitimi neto i Jona shpk për vitin 2020 është €1,260,000. Shpenzimet e tatimit për vitin 2020 janë €140,000.
3. Kosto e Patundshmërive, impijanteve të prodhimit dhe pajisjeve (PIP) më 1 janar 2020 ishte €16,400,000. Kompania zhvlerëson të gjitha pasuritë me metodën drejtvizore 8%. Nuk ngarkon zhvlerësim në vitin e blerjes së pasurive dhe ngarkon zhvlerësimin e plotë në vitin e shitjes. Më 1 maj 2020 Jona e ka shitur një pasuri për €320,000. Kjo pasuri kishte vlerën neto në libra prej €250,000 dhe koston origjinale të blerjes prej €600,000.
4. Shpenzimet e interesit për Jona shpk ishin €36,000.
5. Jona shpk ka paguar dividendën prej €40,000 në vitin 2020. Jona shpk ka propozuar dividendën përfundimtare prej €20,000 për vitin 2020 me datën 10 janar 2021.

## Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 për Jona shpk, në përputhje me kërkesat e SNK 7 Pasqyrat e rrjedhave të arkës.

### Zgjidhja e problemit 2

Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020  
Jona sh.p.k

#### **Aktivitetet operative**                      `000

Fitimi neto	1,260
+Shpenzimet e tatimit	140
Fitimi para tatimit	1,400
+Shpenzimet e interesit	36

#### **Fitimi para interesit dhe tatimit**      **1,436**

Korrigjimet:

Shpenzimet e zhvlerësimit	1,312	(16,400*8%)
Fitimi kapital	(70)	(Cmimi shitës 320-250 VNL)
Rritja në stoqe	(140)	
Zvogëlimi në LL/A	90	
Rritja në LL/P	80	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	2,708	
Interesi i paguar	(18)	
Tatimi i paguar	(90)	
Dividenda e paguar	(40)	

Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet operative                      2,560

#### **Aktivitetet investuese**                      `000

Arkëtimet nga shitja e pasurive	320
Pagesat për blerjen e PIP	(3,492)

Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet investuese                      (3,172)

#### **Aktivitetet financuese**

Arkëtimet nga shitja e aksioneve                      70  
Arkëtimet nga marrja e kredisë afatgjatë 500

Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet financuese                      570

Saldo e parasë së gatshme në fillim (Shënimi 1)	30
Rrjedha neto e parasë së gatshme gjatë vitit	(42)
Saldo e parasë së gatshme në fund	(12)

Shënimi 1

	2020	2019
Paraja e gatshme në dorë	78	80
Mbitërheqja bankare	(90)	(50)
Gjithsej paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	(12)	30

### Tatimi i pagueshëm

Tatimi i paguar (sh.balancuese) 90	<i>Saldo në fillim</i> 80 <i>Shpenzimet e tatimit</i> 140
	<i>Saldo në fund</i> 130

### Interesi i pagueshëm

interesi i paguar (Sh.balancuese) 18	<i>Saldo në fillim</i> 0 <i>Shpenzimet e interesit</i> 36
	<i>Saldo në fund</i> 18

### Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet (VNL)

<i>Saldo në fillim</i> 11,320	<i>Shitja e pasurisë</i> 250
<i>Rivlerësimi</i> 100	<i>Shp. e zhvlerësimit</i> 1,312
<i>Blerja(sh.balancuese)</i> 3,492	
<i>Saldo në fund</i> 13,350	

### **Problemi 3**

Elena shpk. ju ka pyetur ju, një kontabilist financiar për këshilla se si të përcaktoni politikat e duhura të kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet. Fundi i vitit të Elena shpk është 31 Dhjetor.

#### **Kërkesa e detyrës: Pjesa A**

Kontrolluesi financiar i Elena sh.p.k. ju ka kërkuar të përgatitni një raport i cili adreson si në vijim:

- (a) Në përputhje me SNK 8 - *Politikat e kontabilitetit, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*, përshkruani çfarë nënkuptohet me :
- (i) Politikë të kontabilitetit;
  - (ii) Ndryshim në vlerësimet kontabël; dhe
  - (iii) Gabim **(6 pikë)**
- (b) Në lidhje me ndryshimet në vlerësimet kontabël:
- (i) Shpjegoni si bëhet një ndryshim në politikat kontabël;
  - (ii) Shpjegoni si ndodh një ndryshim në politikat kontabël;
  - (iii) Përshkruani trajtimin kontabël për ndryshimin në politikat kontabël; dhe
  - (iv) Përshkruani shpalosjet kyçe të cilat janë të nevojshme për ndryshimet në politikat kontabël **(8 pikë)**

#### **Pjesa B**

Gjatë vitit 2019, Elena shpk ka gjetur se disa mallra janë përfshirë në stoqe me 31/12/2018 me shumë prej 2 milion eur, por të cilat në fakt ishin shitur gjatë vitit 2018.

Shumat e raportuara në P/A për vitin që përfundon më 31/12/2018 dhe shumat për vitin 2019 janë të paraqitura në vijim:

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Shitjet	60,000	57,000
KMSH	<u>(42,000)</u>	<u>(40,000)</u>
Fitimi bruto	18,000	17,000
Shpenzimet e tatimit	<u>(2,000)</u>	<u>(2,000)</u>
Fitimi neto	<u>16,000</u>	<u>15,000</u>

Gabimi në stoqet fillestare të vitit 2019 që është paraqitur më lartë në shumë prej 2 mil eur, është përfshirë në KMSH e vitit 2019.

#### **Kërkohet:**

Paraqitni saktë Pasqyrën e të ardhurave për Elena shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

**(6 pikë)**

**[Totali: 20 pikë]**

### Zgjidhja e problemit 3

#### RAPORT

Për: Kontrolluesin financiar, Elena shpk

Nga: Kontabilisti financiar

Re: SNK8- Politikat kontabël, ndyshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet

#### PJESA A

- a)  
i)

Politikat e kontabilitetit janë parimet, bazat, konventat, rregullat dhe praktikat domethënëse të zbatuara nga një kompani në përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare. Një kompani përcakton politikat e saj të kontabilitetit duke zbatuar Standardet dhe interpretimet e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB). Në mungesë të një Standardi ose interpretimi që mbulon një transaksion specifik, një ngjarje ose kusht tjetër, menaxhmenti përdor gjykimin e tij për të zhvilluar një politikë kontabël, e cila rezulton në informacion që është i rëndësishëm dhe i besueshëm, duke marrë parasysh në rendin vijues.

- Standardet ose interpretimet që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme dhe të ngjashme;
- Kriteret e njohjes dhe përkufizimet sipas Kornizës konceptuale; dhe
- GAAP të tjera kombëtare të bazuara në një kornizë të ngjashme konceptuale (duke bërë të sigurtë se trajtimi nuk bie ndesh me Standardet, interpretimet ose Kornizën ekzistuese).

**(2 pikë)**

ii) Një ndryshim në vlerësimin kontabël është një korigjim i vlerës në libra të një pasurie ose detyrimi, ose shumës së konsumit periodik të një pasurie, që rezulton nga vlerësimi i tanishëm për përfitimet dhe detyrimet e pritura të së ardhës që ndërliken me pasuritë dhe detyrimet. Ndryshimet në vlerësimet kontabël rezultojnë nga informacione të reja ose zhvillimet e reja dhe, në përputhje me rrethanat, nuk janë korigjim i gabimeve.

**(2 pikë)**

iii) Gabimet e periudhës së mëparshme janë lëshime dhe keqdeklarime në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike për një ose më shumë periudha paraprake që dalin si rezultat i mos përdorimit, ose keqpërdorimit të informacionit të besueshëm që:

- (a) ishte në dispozicion kur pasqyrat financiare për ato periudha ishin autorizuar për publikim; dhe
- (b) në mënyrë të arsyeshme mund të pritët që të jenë marrë dhe të merren parasysh gjatë përgatitjes dhe prezantimit të pasqyrave financiare.

Gabimet në PF mund të dalin si rezultat i:

- a) Gabimeve matematikore  
b) Gabimeve në implentimin e politikave kontabël  
c) Keqinterpretimit të fakteve  
d) Mashtrimit

**(2 pikë)**



b)

i) Një ndryshim në politikën e kontabilitetit bëhet vetëm nëse:

(a) kërkohet nga një Standard ose interpretim; ose

(b) rezultatet në pasqyrat financiare ofrojnë informacion më të besueshëm dhe më të rëndësishëm në lidhje me efektet e transaksioneve, ngjarjeve ose kushteve të tjera në financat e kompanisë.

(2 pikë)

ii) Ndryshimi në politikat e kontabilitetit ndodh kur ka ndryshime në:

- Njohjen p.sh tani njihet një shpenzim në vend të pasurisë
- Prezantimin p.sh zhvlerësimi tani përfshihet në shpenzimet e shpërndarjes dhe jo si shpenzim administrativ
- Matja p.sh paraqitja e pasurive me vlerën e zëvendësimit dhe jo me koston historike.

(2 pikë)

iii) Trajtimi kontabël për ndryshimin në politikat e kontabilitetit është si në vijim:

Nëse fillimisht aplikimi i standardit ose interpretimit nuk tregon se si të aplikohet ndryshimi, kompania duhet të aplikojë ndryshimin në mënyrë retrospektive duke:

Riparaqitur shumat krahasuese për secilën periudhë paraprake, duke prezantuar zërat sikur politika e kontabilitetit të ishte duke u implementuar gjithmonë

Korrigjimit të saldove fillesatre për secilin zë të prekur dhe korrigjimet e fitimit/humbjes për periudhat paraprake

Përfshirë korrigjimin në saldon fillestare të ekuitetit në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet

Shpalosur natyrën e ndryshimit dhe shumën e korrigjimit për periudhën e tanishme dhe ato paraprake për secilin zë që ndikohet nga ndryshimi.

(2 pikë)

iv) Shpalosjet kyce në lidhje me ndryshimet në politikat e kontabilitetit janë si në vijim:

- Natyra e ndryshimit të politikës së kontabilitetit
- Arsyeja e ndryshimit
- Shuma e korrigjimit për periudhën e tanishme dhe ato paraprake (2 pikë)

## PJESA B

a) Pasqyra e të ardhurave	2019	2018
	`000	`000
Shitjet	60,000	57,000
KMSH	(40,000) *	(42,000)**
Fitimi bruto	20,000	15,000
Shpenzimet e tatimit	(2,000)	(2,000)
Fitimi neto	18,000	13,000

\*Në vitin 2019 stoqet në fillim duhet të zvogëlohen për 2 mil euro, andaj edhe KMSH është më e vogël për 2 mil euro.

\*\*Në vitin 2018 stoqet në fund duhet të zvogëlohen për 2 mil euro, andaj KMSH duhet të rritet për 2 mil euro.

#### **Problemi 4**

Drita përgatit një pasqyrë të harmonizimit bankar për llogarinë bankare të biznesit të saj në fund të çdo muaji. Në datën 31 Maj 2021 teprica në librin e arkës ishte € 2,759 (kredi) dhe ekstrakti i gjendjes së llogarisë në bankë tregonte se në bankë kishte vetëm € 131. Drita ka informacionet e mëposhtme:

- (i) Banka ka debituar llogarinë e Dritës me shpenzime bankare me vlerë € 129 gjatë Majit. Drita nuk i ka regjistruar këto shpenzime.
- (ii) Drita është marrë vesh me bankën që € 2,500 të transferohen nga llogaria e saj personale bankare në llogarinë bankare të biznesit. Banka ka bërë transfertën në datën 30 Maj, por Drita nuk ka bërë asnjë regjistrim për transaksionin në fjalë në librat e saj.
- (iii) Në datën 22 Maj, Drita tërhoqi € 100 para të gatshme të cilën nuk e ka regjistruar në libra.
- (iv) Çeku numër 543987 të cilin Drita ia ka lëshuar një furnitori duket si € 650 në ekstraktin e gjendjes së llogarisë në bankë. Drita e ka regjistruar çekun gabimisht si € 560.
- (v) Në datën 31 Maj, Drita depozitoi € 457. Kjo shumë mban datën 3 Qershor në ekstraktin e gjendjes së llogarisë në bankë.
- (vi) Dritës i ka treguar banka se ajo ka fituar € 52 interes për muajin Maj për shkak se llogaria ishte në kredi. Drita e regjistroi këtë transaksion në Maj, por banka nuk e ka kredituar llogarinë e saj deri në Qershor.
- (vii) Tre nga çeket e lëshuara në Maj, me një vlerë totale € 942, nuk ishin debituar në ekstraktin e gjendjes së llogarisë në bankë deri në 31 Maj.
- (viii) Një çek me vlerë € 276, që i është lëshuar një furnitori ishte anuluar nga banka, por Drita nuk e ka regjistruar çekun.

#### ***Kërkohet:***

(a) Tregoni korrigjimet e duhura në librin e arkës të Dritës, përfshirë të gjitha hyrjet korrigjuese që kërkohen si rrjedhojë e informacioneve në (i) deri (viii) në sipër.

Kujdes: Ju DUHET të paraqisni përgjigjen tuaj në një format i cili tregon qartë nëse secili regjistrim është një debi ose një kredi.

**(10 pikë)**

(b) Përgatisni një harmonizim të ekstraktit bankar me saldon e librit të arkës të Dritës.

**(10 pikë)**

**(Totali = 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 4

(a)

Libri i arkës			
ii) Transferi	2,500	Saldo e pakorrigjuar	2,759
(viii) Çeku i anuluar	276	i) Shpenzimet	129
		(iii) Tërheqjet e parasë së pajshme	100
Saldo (e korrigjuar)	302	(iv) Çeku i korrigjuar	90
	3,078		3,078

(b) Pasqyra e harmonizimit bankar

	€
Saldo sipas ekstraktit	131
(v) Depozita në transit	457
(vi) interesi	52
(vii) Çeqet e paparaqitura	(942)
	-----
Saldo e korrigjuar (mbi - tërhequr)	(302)
	-----

## Problemi 5

Znj. Krasniqi ju ka kontaktuar juve për t'ia përgatitur grupin e pasqyrave financiare për biznesin e saj, meqenëse do të aplikojë në bordin lokal të ndërmarrjeve vendore për grant që t'i lejojë asaj të zgjerojë biznesin e saj të ëmbëlsirave. Deri më tani, mbajtja e llogarive (kontabilitetit) e Znj.Krasniqi ka qenë e pamjaftueshme, por ajo ka siguruar të dhënat e mëposhtme për ju:

(i) Pasuritë dhe detyrimet

	€	
	1 janar 2020	31 dhjetor 2020
Pajisje kuzhine	10,000	14,000
Furgon për shpërndarje	15,000	13,000
Stoqe	3,000	4,000
Paraja e gatshme	7,200	?
Parapagimi i sigurimit	1,000	1,200
Llogaritë e pagueshme	6,000	8,000
Detyrimi për drita dhe ngrohje(të pagueshme)	300	350

(ii) Paraja e pranuar për vitin ishte si në vijim

-Të gjitha shitjet ishin arkëtuar gjatë vitit 2020, andaj kompania nuk ka Llogari të arkëtueshme.

-Blerjet e mallrave me para të gatshme prej 2,400€ dhe furnizimet e zyrës në vlerë prej 1,100€ janë paguar me para në dorë. Znj. Krasniqi gjithashtu bëri tërheqje të parasë së gatshme nga 50€ çdo javë për veten e saj( *mesatarisht kalkuloni se viti ka 52 javë*).

(iii)Sa i përket shitjeve, Znj. Krasniqi ngarkon marzhën 55.1% *shtim mbi koston* (rrumbullaksoni shumat).

(iv) Znj. Krasniqi ka blerë më 01 janar 2020 disa pajisje me kosto prej 5,000€, blerje me një kredi tre vjeçare nga Banka lokale. Znj. Krasniqi paguan interesin e kredisë në vitin e ardhshëm. interesi i kredisë është 5%.

(v) Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin janë 3,000 €.

(vi) Pagesat bankare gjatë vitit kanë qenë si më poshtë:

	€
Furnitorët (LL/P)	26,000
Riparimet dhe mirëmbajtja	3,400
Karburanti	1,200
Sigurimi (Parapagim)	2,200
Dritat dhe ngrohja	1,600
Shpenzimet e përgjithshme	400
Shpenzimet e pagave	2,150

**KËRKOHET:****Përgatitini**

- a) Pasqyrën e të ardhurave për Znj. Krasniqi për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020.

**(11 pikë)**

- b) Pasqyrën e pozitës financiare për Znj. Krasniqi më 31 dhjetor 2020.

**(9 pikë)****[Total: 20pikë]****Zgjidhja e problemit 5**

- a) Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave për Znj.Krasniqi për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

		€	€
<b>Të hyrat</b>	<b>Shënimi 2</b>		<b>45,600</b>
Kosto e Shitjeve			
Stoqet në fillim		3,000	
+ Blerjet	<b>Shënimi 1</b>	30,400	
- Stoqet në fund		<u>- 4,000</u>	
Total Kosto e Shitjeve			<u>29,400</u>
<b>Fitimi Bruto</b>			<b>16,200</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Riparimet dhe mirëmbajtja		3,400	
Karburanti		1,200	
Sigurimi	<b>Shënimi 3</b>	2,000	
Dritat dhe ngrohja	<b>Shënimi 4</b>	1,650	
Shpenzimet e përgjithshme		400	
Zhvlerësimi		3,000	
Interesi i kredisë	<b>(5,000 * 5%)</b>	250	
Shpenzimet e pagave		2,150	
Shpenzimet e zyrës		<u>1,100</u>	
Total Shpenzimet			<u>15,150</u>
<b>Fitimi Neto</b>			<b>1,050</b>

### Shënimi 1 - Kalkulimet e blerjeve

<b>Llogaria e pagueshme</b>			
	€		€
Pagesat	26,000	Saldo në fillim	6,000
		Blerjet - vlerë balancuese	28,000
Saldo e bartur	8,000		
	<u>34,000</u>		<u>34,000</u>
			8,000
Blerjet me afat pagese	28,000		
Blerjet me para të gatshme	<u>2,400</u>		
Total Blerjet	30,400		

$KMSH = \text{st fillim} + \text{blerjet} - \text{st fund} = 3,000 + 30,400 - 4,000 = 29,400$

### Shënimi 2 - Kalkulimet e të hyrave

<u>Shitjet (155.1%)</u>	<u>45,600</u>
<u>KMSH (100%)</u>	<u>29,400</u>
<u>Fitimi bruto (55.1%)</u>	<u>16,200</u>

Shitjet (29,400 x 1.5510)	<u>45,599.4</u>	
Të hyrat (rumbullakësuar)		45,600

### Shënimi 3 - Kalkulimi i sigurimit

<b>Llogaria e parapagimit të sigurimit</b>			
	€		€
Saldo në fillim	1,000	Shpenzimet - vlerë balancuese	2,000
Pagesat në bankë	2,200	Saldo e bartur	1,200
	<u>3,200</u>		<u>3,200</u>
	1,200		

### Shënimi 4 - Kalkulimi i dritave dhe ngrohjes

<b>Llogaria e Detyrimit për drita dhe ngrohje</b>			
	€		€
Pagesat në bankë	1,600	Saldo në fillim	300
Saldo e bartur	350	Shpenzimet - vlerë balancuese	1,650
	<u>1,950</u>		<u>1,950</u>
			350

**Kalkulimi i transaksioneve të parasë së gatshme duke përdorur llogarinë e parasë së gatshme**

<b>Llogaria e parasë së gatshme</b>			
	€		€
Saldo në fillim	7,200	Furnitorët (Ll/P)	26,000
		Blerjet me P.G.	2,400
		Riparimet dhe mirëmbajtja	3,400
		Karburanti	1,200
Shitjet	45,600	Sigurimi	2,200
		Dritat dhe ngrohja	1,600
		Shpenzimet e përgjithshme	400
		Fuqia punëtore	2,150
		Shpenzimet e zyrës	1,100
		Tërheqjet	2,600
		Saldo e bartur	9,750
	<u>52,800</u>		<u>52,800</u>
	9,750		

## b) Pasqyra e pozitës financiare

Pasqyra e pozitës financiare për Znj.Krasniqi më 31 dhjetor 2020

	€	€	€
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona, Fabrika dhe Pajisjet	<u>27,000</u>		
<b>Total pasuritë jo-qarkulluese</b>			<b>27,000</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet	4,000		
Llogaritë e arkëtueshme	-		
Keshi dhe ekuivalentët e tij	9,750		
Parapagimet	<u>1,200</u>		
<b>Total pasuritë qarkulluese</b>		<b>14,950</b>	
<b>Total Pasuritë</b>			<b>41,950</b>
<b>Ekuiteti dhe Detyrimet</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali më 01/01/2020 (shifër balancuese)	29,900		
Tërheqjet	- 2,600		
Fitimi neto	<u>1,050</u>		
<b>Total Ekuiteti</b>			<b>28,350</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Kredia bankare		<u>5,000</u>	
<b>Total detyrimet afatgjata</b>		<b>5,000</b>	
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme	<b>Shënimi 1</b>	8,000	
Akrualet - dritat dhe ngrohja		350	
Akrualet - interesi në kredi		<u>250</u>	
		<b>8,600</b>	
<b>Total detyrimet</b>			<b>13,600</b>
<b>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</b>			<b>41,950</b>